REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
MINISTRI

Nr. 22900/14 Prot. Tiranë, më 4.4.2019

URDHËR

Nr. 122, Datë 4.4.2019

PËR
FILLIMIN E PROCEDURËS PËRZGJEDHËSE TË KANDIDATIT PËR ANËTAR BORDI TË AUTORITETIT TË MBIKËQYRJES FINACIARE QË DO TË MBAJË FUNKSIONIN E NËNDREJTORIT EKZEKUTIV

Në mbështetje të neneve 4, 5, 7 të ligjit nr. 9572, datë 3.7.2006 "Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare" të ndryshuar, si dhe në zbatim të paragrafit të katërt të nenit 6 të këtij ligji;

Me qëllim, përzgjedhjen e kandidatit për anëtar bordi të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare që do të mbajë funksionin e Nëndrejtorit Ekzekutiv, i cili sipas procedurës dhe përcaktimeve ligjore do t'i propozohet nga Ministri i Financave dhe Ekonomisë, Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, për emërim,

URDHËROJ:

1) Fillimin e procedurës përgjedhëse të kandidatit për anëtar bordi të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare që do të mbajë funksionin e Nëndrejtorit Ekzekutiv, i cili sipas procedurës dhe përcaktimeve ligjore, do t'i propozohet nga Ministri i Financave dhe Ekonomisë, Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, për emërim.
2) Në përputhje me përcaktimet e parashikuara në nenin 5 të ligjit nr. 9572, datë 3.7.2006 "Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare" të ndryshuar, kandidati duhet të plotësojë kërkesat e mëposhtme:
   a) Të jetë shtetas shqiptar;
   b) Të ketë kryer arsimin e lartë ekonomik, juridik ose të lidhur me shkencën e aktuarëve.
   c) Të ketë përvojë pune 7-vjeçare, nga e cila të paktën 5 vjet në njerën nga këto fusha ose disa prej tyre të marra sëbashku:
      - Financë-kontabilitet;
      - Administrim i shoqërive tregtare;
      - Këshillim ligjor i shoqërive tregtare;
      - Hartim legjislacioni;
      - Shkencë e aktuarëve;

- Sigurime shoqërore dhe pensione.

ç) Të ketë integritet moral dhe profesional.
d) Të jetë i paangazhuar në funksione drejtuese partiake.
e) Të mos jetë i dënuar penalisht, me vendim gjykate të formës së prerë.
f) Të jetë në përmbushje të kërkesave dhe dispozitave ligjore për konfliktin e interesave.

3) Përbën avantazh për kandidatin përmbushja edhe e kritereve të tjera plotësuese, si:
   a) Studime të avancuara në fushën e financave, të administrimit të biznesit dhe drejtësisë (master ose doktoraturë);
   b) Përvojë pune në fushën e sigurimeve/fondeve të pensioneve/fondeve të investimeve;
   c) Përvojë drejtimi në nivele të larta;
   d) Aftësi të shkëlqyera në të folur dhe në të shkruar të gjuhës angleze.
4) Nuk mund të jetë në këtë funksion, kandidati, i cili:
   a) Në tre vitet e fundit ka qenë ortak, aksionar, apo anëtar i organeve drejtuese të subjekteve të mbikëqyrura;
   b) Ka lidhje familjare me personat e parashikuara në pikën 4 "a" të këtij Urdhëri;
   c) Në tre vitet e fundit ka qenë punonjës me kohë të pjesshme apo të plotë në subjektet e mbikëqyrura.
5) Kandidati duhet të dorëzojë në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë (Sektori i Arkiv-Protokollit) këto dokumenta:
   a) Kërkesë për aplikim;
   b) Kopje e kartës së identitetit;
   c) Dokument që të provojë vjetësinë në punë në një nga fushat e kërkuara;
   d) Jetëshkrim (*Curriculum Vitae*-CV);
   e) Deklaratë personale për mos angazhim në funksione drejtuese partiake;
   f) Dëshmi penaliteti dhe vërtetim që nuk ndodhet në ndjekje penale;
   g) Deklaratë për përmbushjen e kërkesave dhe dispozitave ligjore për konfliktin e interesave;
   h) Çdo dokument tjetër të nevojshëm në funksion të përmbushjes së kërkesave të përcaktuara në pikën 3 të këtij Urdhëri.
6) Afati i dorëzimit të aplikimit dhe dokumenteve të përcaktuara në urdhër, është deri më datë 18.4.2019, ora 14:00.
7) Njoftimi i fillimit të procedurës sipas këtij Urdhëri, të publikohet në faqen zyrtare të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, brenda datës 5.4.2019.
8) Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij urdhëri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTËR

Anila DENAJ